



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2303 prot.

Pukë, më 16.12.2022

PROJEKT - VENDIM

Nr. 12 Datë 16.12.2022

PËR DHËNIE TITULLI QYTETAR NDERI I BASHKISË PUKË

Z. Selim Rexhep Dini
(Pas Vdekjes)

Këshilli i Bashkisë Pukë në zbatim të nenit 54, pika “m” të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; të nenit 3, pika 1; nenit 14, pika 1; nenit 15, pika 1/a dhe 2; nenit 16, pika 1; nenit 17; nenit 18; nenit 19; nenit 20, pika “ç”; të ligjit nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 113, pika “dh”, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me Propozim të Kryetarit të Bashkisë ,

V E N D O S I :

1. T’i jepet titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Pukë, **z. Selim Rexhep Dini (pas vdekjes)** me motivacionin:

“Për cilësi të larta profesionale, në poste drejtuese dhe organizuese në fushen e bujqësisë dhe të pyjeve si dhe për kontributin e dhënë me vlera dhe ndikim pozitiv në sektorët përkatës.”

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, i ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Drejtor DMBNJ
Emirjona Pergjegjaj

Jurist
Aida Sinani

KRYETARI
Gjon Gjonaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2303/prot.

Pukë, më 16.12 2022

Relacion

PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR DHËNIE TITULLI “QYTETAR NDERI”

Z. Selim Rexhep Dini
(Pas Vdekjes)

Mbështetur në ligjin nr. **139/2015** “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin **112/2013**, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, (ndryshuar me ligjin nr. **10/2015**, datë **19.2.2015**), pas vlerësimit të kërkesës së bërë për dhënien e titullit qytetar nderi **z. Selim Rexhep Dini (pas vdekjes)** me qëllim që të vlerësohet puna dhe kontributi i tij, Këshilli i Bashkisë duke konsideruar propozimin, ju propozon anëtarëve të Këshillit Bashkiak që të vlerësohet figura e tij dhe personaliteti, duke ju dhënë titulli i nderit në shenjë respekti dhe mirënjohjeje publike për të gjithë kontributin dhe përkushtimin e tij në fushën e bujqësisë dhe te pyjeve. I lindur me datë 31.03.1950 në Pukë. Vazhdoi studimet pranë Institutit të Lartë Bujqësor në Tiranë në degën silvikulturë në vitet 1969-1974. E filloi karrierën e tij si teknik i mesëm në vitin 1968-1969 në Ndërmarrjen Pyjore Fushë-Arrëz dhe pas studimeve punoi si specialist inxhinier në Ndërmarrjen Pyjore Fushë-Arrëz duke qendruar për 4 vite nën detyrën e kryeinxhinierit pranë po së njejtës ndërmarrje. Ka kryer detyrën e drejtorit nga viti 1980-1989 pranë së njejtës ndërmarrje. Nga viti 1989-1993 është transferuar nga Puka në Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve, Ministria e Bujqësisë. Karriera e tij ka kaluar në shumë etapa dhe vende pune të ndryshme. Vlerave të tij profesionale i bashkëngjiten dhe ato humane duke shërbyer në çdo kohë dhe vend për bashkëqytetarët e tij.

Me propozim të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

T’i jepet titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Pukë, **z. Selim Rexhep Dini (pas vdekjes)** me motivacionin:

“Për cilësi të larta profesionale, në poste drejtuese dhe organizuese në fushën e bujqësisë dhe të pyjeve si dhe për kontributin e dhënë me vlera dhe ndikim pozitiv në sektorët përkatës.”

Ky titull i jepet në shenjë nderimi dhe vlerësimi për të gjithë punën dhe kontributin e dhënë në fushën e bujqësisë dhe pyjeve, **z. Selim Rexhep Dini (pas vdekjes)**.

1. Për të gjitha meritat e lartpërmendura propozohet t’i akordohet titulli “Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë”.

Drejtore Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
Emirjona Pergjegjaj

PROPOZIM

PËR DHENJE TITULLI QYTETAR NDERI I BASHKISË PUKË, TË NDJERIT SELIM REXHEP DINI

Z. Gjon Gjonaj – KRYETAR I BASHKISË PUKË

NË VEMENDJE: KËSHILLIT BASHKIAK BASHKIA PUKË

I nderuar Kryetar!

Të nderuar Anëtar të Këshillit Bashkiak, Bashkia PUKË

Nisur nga kontributi, dhe cilësitë njerëzore, morale dhe shoqërore të Selim Rexhep Dinit, si specialist i pyjeve, si kryetar i degës Teknike në Ndërmarrjen e Pyjeve Fushë-Arrëz, dhe për 10 vite si drejtor i kësaj ndërmarrje, më tej për disa vite specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve, Ministria e Bujqësisë, për tre vite Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Tiranë, si konsulent Kombëtar i Organizatës Botërore të Ushqimit, duke lozur një rol esencial në mbarëvajtjen e punëve në tërë sektorët ku ka punuar dhe drejtuar, kontribut i të cilit për Pukën ka qenë i dukshëm, ndaj për të gjitha këto cilësi dhe kontribute, propozojmë që Selim Raxhep Dini, t'i jepet titulli:

QYTETAR NDERI I BASHKISË PUKË, PAS VDEKJES, ME KËTË MOTIVACION

“ Për cilësi të larta profesionale, si specialist i pyjeve, për merita të dukshme drejtuese dhe organizuese në disa poste drejtor në Ndërmarrjen e Pyjeve Fushë-Arrëz, Pukë, dhe Ndërmarrjen e Shfrytëzimit Pyjor, në Tiranë, si dhe për kontributin e dhenë në shkallë kombëtare si në Ministrinë e Bujqësisë dhe si konsulent organizmat Botërore FAO, kontribut me vlera dhe ndikim pozitiv në sektorët përkatës”.

Grupi Nismëtar

Sulejman Sula

Mirash Lulashi

Nikoll Delija

Bilbil Dera Gjergj Ndou

Mark Gjoka

Gjergj Deda

Ndoc Prendi

Pashk Alia

Barollak Beqaj

Seferi Haxhi

Edi Haxhi

Barollak Beqaj

C.V- VITAE E SELIM REXHEP DINI

U lind në Lagjen Kukaj, Pukë, në trungun e një familjeje me tradita dhe atdhetare më 31.03.1950
Mbaroj arsimin 8-vjeçar në vitin 1964, në Qytetin Pukë.

Nga viti 1964-1968, përfundoj në Shkodër arsimin e mesem profesional pyjor.

Nga viti 1969-1974, përfundoj arsimin e lartë në profilin Inxhinier Pyjesh dega "Silvikulturë",
në Institutin e Lartë Bujqësor Tiranë.

Ka punuar si teknik i mesem pas shkollës mesme, në vitin 1968-1969, në Ndërmarrjen Pyjore
Fushë-Arrëz.

Sapo përfundoj arsimin e lartë, në vitin 1974-1975, punoj specialist inxhinier në Ndërmarrjen
Pyjore Fushë Arrëz, Pukë.

Nga vitin 1976-1980 kreu detyrën e kryeinxhinierit në të njëjten ndërmarrje. Gjatë kësaj klohe
manifestoj aftësi profesionale dhe drejtuese.

Në vitrin 1980-1989 ka kryer detyrën e Drejtorit të Ndërmarrjes së Pyjeve Fushë-Arrëz. Për
shumë vite ka qenë Anëtar i Komitetit Ekzekutiv KP Rrethit Pukë.

Nga viti 1989-1993, me kërkesë të Ministrisë së Bujqësisë është transferuar nga Puka dhe ka
punuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve, Ministria e Bujqësisë Tiranë.

Në vitet 1993-1998 , ka punuar drejtues teknik në Shoqërinë "Lorenzo Tirana", Tiranë.

Nga viti 1998 deri në vitin 2002, ka kryer detyrën e Drejtorit të Ndërmarrjes së Shërbimit Pyjor
Tiranë.

Në 2002 punoj konsulent Kombëtar i Organizatës Botërore të Ushqimit, FAO

Nga nentor 2002 deri janr 2006, ka punuar në Sektorin e Marketingut dhe Kullotave, Drejtoria e
Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave, Tiranë.

Si bie në sy edhe nga CV-a e tij, Selimi ka kaluar shkallë të shumta drejtuese dhe kudo ka punuar
është dalluar si njohës i punëve të profesionit në Sektorët e Pyjeve, por edhe si drejtues me nivel
dhe organizator i mirë, duke qëndruar në lartësine e kërkesave të detyrave. Ka shfaqur cilësi të
mira shoqërore dhe përkushtim e seriozitet si drejtues shtetëror.

Për të gjithë kontributin dhe cilësit e tij, grupi nismëtar, i propozon Këshillit Bashkiak Pukë, për
ti dhenë titullin " Qytetar nderi ", i Bashkisë Pukë, mbas vdekjes. **Grupi Nismëtar**




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU Shkodër , RRETHI Pukë

017164912

Zyra e Gjendjes Civile (Arkiva) Rrethi Pukë

Pukë, më 13/10/2022



ÇERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit QYTET PUKE Nr. 06 faqe. 06

, të vitit 1950-1974

vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emri e mbiemri	Emri i babait	Emri i nënës	Gjinia	Lidhja me K.familjarin	Datëlindja			Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia
						Dita	Muaji	Viti			
1	Rexhep Dini	Sallh	Halë	M	Kryefamiljar	03	10	1907	I/e martuar	Puke Puk	Shqiptare
2	Nurije Dini	Asman	Fatë	F	Bashkeshortit/e	14	08	1918	I/e martuar	Micoj Puk	Shqiptare
3	Alë Dini	Rexhep	Nurije	F	E bija	10	09	1942	Beqar/e	Puke Puk	Shqiptare
4	Laje Dini	Rexhep	Nurije	F	E bija	06	08	1946	Beqar/e	Puke Puk	Shqiptare
5	Mite Dini	Rexhep	Nurije	F	E bija	29	08	1948	Beqar/e	Puke Puk	Shqiptare
6	Selim Dini	Rexhep	Nurije	M	I biri	31	03	1950	I/e martuar	Puke Puke	Shqiptare
7	Zarife Dini	Rexhep	Nurije	F	E bija	11	02	1952	Beqar/e	Puk Puk	Shqiptare
8	Halit Dini	Rexhep	Nurije	M	I biri	14	07	1954	Beqar/e	Puke Puke	Shqiptare
9	Shpresa Dini	Veil	Hati	F	E reja	11	01	1952	I/e martuar	Blinisht Lushnje	Shqiptare
10											

Kjo certifikatë lëshohet për

DOKUMENT

Nënpunësi i Gjendjes Civile

Rexhep Dini ka ndryshuar vitin e lindjes nga 1914 në 1907 me Aktin Nr. 15 datë 14.08.1968